



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2019:262327

Datë: 05.04.2024

Numri i dokumentit: 05554213

KA.nr. 507/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Arnis Dumani, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “AriBeg” L.L.C., me numër të regjistrimit 71241602 me pronar R.M. nga Peja, rruga “...”, nr.... kundër të paditurit Ministria e Tregtisë dhe Industrisë Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave, Agjencisë për Pronësi Industriale me seli në Prishtinë, për shkak anulimit të vendimit nr.12/16 të datës 28.07.2016, jashtë seancës, më datë 05.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET POSHTË padia me nr. KA.nr.507/23 e paditësit “AriBeg” L.L.C., me numër të regjistrimit 71241602 me pronar R.M. nga Peja, kundër të paditurit Ministria e Tregtisë dhe Industrisë për shkak anulimit të Vendimit nr.12/16 të datës 28.07.2016, për arsye se paditësi nuk e ka plotësuar padinë sipas aktvendimit të gjykatës të datës 05.01.2024.

A r s y e t i m

Paditësi “AriBeg” L.L.C me numër të regjistrimit 71241602 me pronar R.M. nga Peja, pranë kësaj gjykate ka iniciuar konflikt administrativ me kërkesë për anulimin e Vendimit nr.12/16 të datës 28.07.2016 të paditurit Ministria e Tregtisë dhe Industrisë.

Me Aktvendimin K.DH.SH.II.nr.1114/22 të datës 12.07.2023 Gjykata Komerciale- Dhoma e Shkallës së Dytë ka aprovuar si të bazuar ankesën e paditësit “AriBeg” L.L.C me pronar R.M. nga Peja dhe ka prishur Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative, A.nr. 1305/16 të datës 14.01.2020 dhe lëndën e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata me datë 14.12.2023 ka caktuar seancën në rigjykim, në të cilën seancë ka prezantuar përfaqësuesi i autorizuar i të paditurit, kurse përfaqësuesi i autorizuar i paditësit nuk ka prezantuar edhe pse ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt.

Gjykata me Aktvendimin KA.nr. 507/23 të datës 05.01.2024 ka ftuar përfaqësuesin e paditësit që të bëjë rregullimin e padisë në kuptim të saktësimit të cilësisë së palës paditëse dhe e ka paralajmëruar se nëse nuk i mënjanon të metat e padisë, gjykata do ta hedh poshtë padinë në kuptim të nenit 33 par.2 të LKA-së.

Përfaqësuesi i paditësi edhe pse me datë 11.01.2024 e ka pranuar Aktvendimin KA.nr. 507/23 të datës 05.01.2024 për plotësimin e padisë, i njëjti nuk ka vepruar sipas tij, pra nuk e ka bërë rregullimin e padisë brenda afatit të përcaktuar, andaj duke pasur parasysh faktin që të metat e padisë janë të atilla që e pa mundësojnë zhvillimin e procedurës gjyqësore në këtë konflikt administrativ, gjykata në pajtim me nenin 33.2 të LKA-së vendosi ta hedh poshtë padinë e paditësit.

Neni 33 par.2 i LKA-së përcakton se: *“Nëse paditësi, brenda afatit të cekur, nuk i mënjanon të metat e padisë, kurse ato janë të atilla që e pamundësojnë zhvillimin e procedurës, gjykata do ta hedhë poshtë me vendim padinë, nëse nuk konstaton se akti administrativ i kontestuar është i pavlefshëm.”*

Andaj, gjykata në kuptim të nenit 33 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.507/23, datë 05.04.2024

Gjyqtari

Arnis Dumani

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.